



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 756/2024

Datë: 11 korrik 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 19 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 11 korrik 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Z. Njazi Rexha, prokuror në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, caktohet ushtrues i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
2. Z. Njazi Rexha do të ushtrojë këtë pozitë nga data 02 gusht 2024, deri në emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
3. Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, z. Njazi Rexha, është i obliguar të ushtroj kompetencat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Z. Rexha ka të drejtë në benificionet që dalin nga ushtrimi i funksionit të ushtruesit të detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.
5. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Ardian Hajdaraj



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Z. Njazi Rexha;
- Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.